

VENDIM
Nr. 426, datë 10.6.2026

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIM DEPOJE NË ZONËN E QYTETIT TË NXËNËSVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim depoje në zonën e Qytetit të Nxënësve”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ujësjiellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “ullishte”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 431 283.84 (një milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 431 283.84 (një milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë e katër) lekësh, përballohet nga Ujësjiellës-Kanalizimet Tiranë sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Ujësjiellës-Kanalizimet Tiranë sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Ujësjiellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

8. Ujësjiellës-Kanalizimet Tiranë sh.a. kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Ujësjiellës-Kanalizimet Tiranë sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a., sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë për Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a., sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Bashkia Tiranë, Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë sh.a. dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIM DEPOJE NË ZONËN E QYTETIT TË NXËNËSVE”

Nr.	Të dhënat e pronësisë			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)					Vlerësimet për shpronësim, sipas llojit të pasurisë			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	“Ullishte”		Vlera totale	
									Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)		
1	Esat Violeta	Fevri Fevri	Pazari Pazari	Tiranë	3292	57/2	Ullishte	5,000	166.67	448	74,668.16	74,668.16
2	Isidor	Stavri	Rudho	Tiranë	3292	51/158	Ullishte	10,311.60	84.1	448	37,676.80	37,676.80
3	Violeta	Fevri	Pazari	Tiranë	3292	60/29	Ullishte	5,200	304.3	448	136,326.40	136,326.40
4	Esat Violeta	Fevri Fevri	Pazari Pazari	Tiranë	3292	51/283	Ullishte	49,781.6	2,639.76	448	1,182,612.48	1,182,612.48
Vlera totale											1,431,283.84	